**V E N D I M**
**Nr. 537, datë 24.10.2002**

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURISË SË PALUAJTSHME, QË PREKET NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-DURRËS, SEKSIONI I DYTË SUKTH-DURRËS (KRYQËZIMI I URËS SË DAJLANIT)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në zbatim të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik", me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurisë së paluajtshme të pronarëve, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Durrës, seksioni i dytë Sukth-Durrës (Kryqëzimi i Urës së Dajlanit).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, të cilët shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi, me sipërfaqe 1199 m2 tokë truall e një objekt me sipërfaqe 144 m2, vlerësuar në shumën e përgjithshme prej 10 800 740 (dhjetë milionë e tetëqind mijë e shtatëqind e dyzet) lekësh.

4. Vlera e shpenzimeve procedurale të jetë në shumën prej 115 500 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekësh.

5. Fondi prej 10 916 240 (dhjetë milionë e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet) lekësh, për kompensimin e pronarëve të shpronësuar dhe shpenzimet procedurale, sipas pikave 3 dhe 4 të këtij vendimi, të përballohet nga buxheti i vitit 2002, zëri "Shpronësime", miratuar për Ministrinë e Transportit dhe të Telekomunikacionit.

6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.10.2002.

7. Ngarkohet Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

QARKU: DURRES
BASHKIA: DURRES

LISTA E PERSONAVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHKAK TË NDËRTIMIT TË KRYQËZIMIT TË URËS SË DAJLANIT, PJESË E SUPERSTRADES SUKTH – DURRËS.

Lloji i pasurise se paluajtshme: truall dhe ndërtesë nr.1-9.

| | PRONAR | | | TRUALL | | | NDËRTESE | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Emer | Mbiemer | Nr.Pasurise | Sip/m2 | leke/m2 | Vlera leke | Sip/m2 | leke/m2 | Vlera leke | Totali leke | Shenime |
| 1 | Dashamir | Luga | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 2 | Pranvera | Luga(Kalaci) | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 3 | Sanije | Luga(Hyskja) | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 4 | Liri | Luga(Fani) | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 5 | Gezim | Luga(Fani) | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 6 | Hysen | Luga | 7 49 | 106 | 5500 | 583000 | | | | 583000 | |
| 7 | Kol | Hudhra | | 563 | 5500 | 3096500 | | | | 3096500 | Proces regjistrimi |
| 8 | Myfit | Myrtaj | 5 43 | | | | 72 | 29210 | 2103120 | 2103120 | |
| 9 | Hanushe | Myrtaj | 5 43 | | | | 72 | 29210 | 2103120 | 2103120 | |
| | SHUMA | | | 1199 | | | 144 | | | 10800740 | |

Shpenzime procedurale që përfshijnë botimin 115 500 lek.

Vlera totale e shpronësimit 10 916 240 lek.